

Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim, i parashtruar nga ALFI, menaxhim i fondeve alternative të investimeve , d.o.o. (ALFI, upravljanje alternativnih investicijskih skladov, d.o.o.), me seli të regjistruar në adresën rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, përmes personit të autorizuar avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 24.08.2022, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin ALFI, menaxhim i fondeve alternative të investimeve , d.o.o. (ALFI, upravljanje alternativnih investicijskih skladov, d.o.o.), me seli të regjistruar në adresën rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, synon të fitoj kontroll të pavarur mbi shoqërinë **SPORTINA, tregti e jashtme dhe e brendshme me shumicë dhe pakicë, prodhim, përfaqësim, ndërmjetësim dhe organizim, Bled, d.o.o.** (SPORTINA, zunanja in notranja trgovina na debelo in drobno, proizvodnja, zastopanje, mesrodiki in organizacija, Bled, d.o.o), me seli në adresën Alpska Cesta 43, 4248 Leshe, Slloveni, me anë të blerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 29.07.2022, e plotësuar më 03.08.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga ALFI, menaxhim i fondeve alternative të

investimeve , d.o.o. (ALFI, upravljanje alternativnih investicijskih skladov, d.o.o.), me seli të regjistruar në adresën rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, me të cilën ALFI, menaxhim i fondeve alternative të investimeve , d.o.o. synon të fiton kontroll të pavarur mbi shoqërinë SPORTINA, tregti e jashtme dhe e brendshme me shumicë dhe pakicë, prodhim, përfaqësim, ndërmjetësim dhe organizim, Bled, d.o.o. (SPORTINA, zunanja in notranja trgovina na debelo in drobno, proizvodnja, zastopanje, mesrodiki in organizacija, Bled, d.o.o), me seli në adresën Alpska Cesta 43, 4248 Leshe, Slloveni, me anë të blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

ALFI, menaxhim i fondeve alternative të investimeve , d.o.o. është menaxher i fondeve alternative të investimeve , i regjistruar në Agjencinë e Tregut të Letrave me Vlerë të Sllovenisë. ALFI, menaxhimi i fondeve alternative të investimeve , d.o.o analizon investimet (potenciale) dhe menaxhon fondet e investimeve, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve kalon pjesërisht në shoqëri të tjera dhe administron edhe fondin e investimeve Alfi II, i cili u themelua me emrin ALFI, Fondi special i investimeve. ALFI, Specialni injekcije sklad), me numër regjistrimi 7239327002.

ALFI, menaxhimi i fondeve alternative, të investimeve d.o.o dhe fondi Alfi II, si dhe personat e lidhur me to, duke përfshirë shoqëritë e portofolit që i kontrollojnë, janë një ndërmarrje dhe janë pjesë e Grupit Alfi.

Grupi Alfi ka shoqëritë e varura të mëposhtme të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

PRO KOLEKT SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Hristo Tatarçev 121-G Kisela Vodë, Shkup, një shoqëri aktive me pagesën e borxheve jashtë gjykatës.

APOLLO MK SHPKNJP DOOEL Shkup, me seli në Bulevardi Kiro Gligorov nr. 13, Gazi Babë, Shkup, e cila është aktive në shitjen me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesorëve për fëmijë dhe produkteve tekstile për fëmijë.

SPORTINA, tregti e jashtme dhe e brendshme me shumicë dhe pakicë, prodhim, përfaqësim, ndërmjetësim dhe organizim, Bled, d.o.o. është e regjistruar në Slloveni dhe merret me tregtinë me pakicë të veshjeve në dyqane të specializuara. SPORTINA, tregti e jashtme dhe e brendshme me shumicë dhe pakicë, prodhim, përfaqësim, ndërmjetësim dhe organizim, Bled, d.o.o. dhe personat e lidhur me të janë pjesë e Grupit SPORTINA dhe janë aktivë në Slloveni, Kroaci, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Bullgari dhe Austri.

Grupi SPORTINA nuk ka shoqëri të varura e të regjistruara në Maqedoninë e Veriut, por ka arritur të ardhura nga shitjet në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe

pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски